



**KONVENTA E KËSHILLIT
TË EVROPËS PËR
PARANDALIMIN DHE LUFTËN
KUNDËR DHUNËS NDAJ
GRAVE DHE DHUNËS
NË FAMILJE**

Konventa
e Stambollit

**TË SIGURTË NGA FRIKA
TË SIGURTË NGA
DHUNA**

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



CILI ËSHTË QËLLIMI I KËSAJ KONVENTE?

■ Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje është traktati më i përparuar ndërkombëtar për të trajtuar te tilla shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Konventa synon të sigurojë tolerancë zero për këtë lloj dhune dhe është një hap i madh përpara për ta bërë Evropën më të sigurt.

■ Parandalimi i dhunës, mbrojtja e viktimave të saj dhe ndjekja penale e dhunuesve janë gurët e themeleve të kësaj konvente. Ajo synon gjithashtu të ndryshojë mendësitë e individëve duke iu bërë thirrje pjesëtarëve të shoqërisë, në veçanti burrave dhe djemve, të ndryshojnë sjellje. Në thelb, konventa është një thirrje e re për barazi ndërmjet burrave dhe grave, pasi dhuna ndaj grave i ka rrënjët thellë në pabarazinë shoqërore dhe ka vijuar për shkak të kulturës të mostolerancës dhe mohimit.

TIPARET NOVATORE TË KONVENTËS

■ Konventa e njej dhunën ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut dhe si formë diskriminimi. Kjo do të thotë që shtetet kanë përgjegjësi nëse nuk i përgjigjen në mënyrën e duhur kësaj dhune.

■ Konventa është traktati i parë ndërkombëtar që përmban një përkufizim të gjinisë. Kjo do të thotë që tashmë njihet që gratë dhe burrat nuk janë thjesht qenie biologjike femërore apo mashkullore, por që ekziston një kategori sociale e gjinisë që përcakton rolet dhe sjelljet e grave dhe burrave. Rezultatet e kërkimeve tregojnë se disa role dhe sjellje të caktuara mund të kontribuojnë në inkurajimin e dhunës kundër grave.

■ Konventa kriminalizon vepra të tilla si: gjymtimin gjinor, martesën e detyruar, përndjekjen, abortin dhe sterilizimin e detyruar. Kjo do të thotë që shtetet do të detyrohen, për herë të parë të përfshijnë këto vepra penale në sistemet e tyre ligjore.

■ Konventa bën thirrje për përfshirjen e të gjitha institucioneve dhe shërbimeve përkatëse shtetërore, në një qasje të koordinuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Kjo do të thotë që institucionet dhe organizatat jo-qeveritare nuk duhet të veprojnë vetëm, por të punojnë së bashku për të përpiluar protokolle bashkëpunimi.

ÇFARË DUHET TË BËJNË SHTETET SIPAS KONVENTËS?

PARANDALIM

- ▶ ndryshim të sjelljeve, roleve dhe stereotipeve gjinore që e bëjnë të pranueshme dhunën ndaj grave;
- ▶ trajnim të profesionistëve që punojnë me viktimat;
- ▶ rritje të ndërgjegjësimit për format e ndryshme të dhunës dhe për natyrën e tyre traumatizuese;
- ▶ përfshirje të çështjeve të barazisë gjinore në kurrikulat e të gjitha niveleve të arsimit;
- ▶ bashkëpunim me OJQ-të, median dhe sektorin privat për të ndërgjegjësuar publikun.

MBROJTJE

- ▶ vendosjen e nevojave dhe sigurise se viktimave ne qender te te gjitha politikave;
- ▶ krijimin e shërbimeve dhe strukturave të specializuara për dhënien e ndihmes mjekësore si dhe keshillimin psikologjik dhe ligjor të viktimave dhe fëmijëve të tyre;
- ▶ vënien në dispozicion të një numri të mjaftueshëm strehëzash si dhe të një linje telefonike 24-orëshe pa pagesë.

NDJEKJE PENALE

- ▶ dhuna ndaj grave të konsiderohet si veprë penale dhe të dënohet sipas ligjit;
- ▶ justifikimet në bazë të kulturës, zakoneve, fesë ose të ashtuquajturin “nder” të konsiderohen si të papranueshme për çdo akt dhune;
- ▶ viktimave t’u sigurohen masa të posaçme mbrojtje gjatë hetimit dhe proceseve gjyqësore ;
- ▶ institucionet e zbatimit të ligjit t’u përgjigjen menjëherë thirrjeve për ndihmë dhe të menaxhojnë në menyërën më të përshtatshme situatat e rrezikshme.

POLITIKA TË INTEGRUARA

- ▶ të sigurojnë përfshirjen e të gjitha masave të mësipërme në një katalog të vetëm të politikave dhe të ofrojnë një përgjigje të përbashkët ndaj dhunës kundrejt grave dhe dhunës në familje.





KË MBËSHTET KONVENTA?

■ Konventa mbron të gjitha gratë dhe vajzat, pavarësisht nga mosha, raca, feja, origjina sociale, statusi migrator apo orientimi seksual. Konventa njeh se ka grupe grash dhe vajzash të cilat shpesh janë në rrezik më të madh për të përjetuar dhunë dhe se si rrjedhojë shtetet duhet të garantojnë dhe marrin parasysh nevojat e tyre specifike. Po ashtu, shtetet inkurajohen të zbatojnë konventën dhe për viktimat të tjera të dhunës në familje, si: burrat, fëmijët dhe të moshuarit.

ÇFARË VEPRASH PENALE MBULOHEN NGA KONVENTA?

■ Konventa iu kërkon shteteve të kriminalizojnë ose ndëshkojnë aktet e mëposhtme :

- ▶ dhunën në familje (dhunën fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike)
- ▶ përndjekjen;
- ▶ dhunën seksuale, duke përfshirë edhe përdhunimin;
- ▶ ngacmimet seksuale;
- ▶ martesat e detyruara;
- ▶ gjymtimin e organeve gjenitale të femrave;
- ▶ abortin ose sterilizimin e detyruar.

■ Ky përcaktim jep një mesazh të qartë se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje nuk janë më çështje private. Përkundrazi, për të theksuar efektin e madh traumatizues të krimeve brenda familjes, mund të vendoset një dënim më i rëndë për dhunuesin në rastet kur viktimat është bashkëshortja, partnerja ose një anëtar i familjes.



SI MONITOROHET VËNIA NË ZBATIM E KONVENTËS

— Konventa parashikon krijimin e një mekanizmi monitorues për të vlerësuar se si vihen në zbatim nenet e saj. Ky mekanizëm monitorues konsiston në dy organizma : Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO), një grup ekspertësh të pavarur, dhe Komiteti i Palëve, një organizëm politik i përbërë nga përfaqësues zyrtarë të Shteteve palë në Konventë. Gjetjet dhe rekomandimet e tyre do të ndihmojnë shtetet të zbatojnë konventën si dhe të garantojnë efikasitetin e saj afatgjatë.

www.coe.int/conventionviolence
conventionviolence@coe.int

SQI

www.coe.int

Këshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare, të cilët mbulojnë praktikisht të gjithë kontinentin e Evropës, 28 nga të cilët janë anëtare të Bashkimit Europian. Gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, një traktat i hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin ligjor. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikqyr zbatimin e konventës në vendet anëtare.

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE